



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.774/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Gentiana Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës, e përfaqësuar nga Danush Ademi, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.202, për shkak të manipulimit të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 10.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET i pasafatshëm apeli Anr.774/2019 i datës 09.03.2021, i paraqitur nga subjekti politik, Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës, e përfaqësuar nga Danush Ademi, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.202, për shkak të manipulimit të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të datës 14.02.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 09.03.2021, ka pranuar një apel nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës, i përfaqësuar nga Danush Ademi, në të cilin subjekti politik në fjalë pretendon se bazuar në argumentet e ofruara nga Insajderi-portal i mediave ku subjekti politik IRDK, ka blerë dhe ka manipuluar me vota konsiderojnë se si subjekt politik janë dëmtuar dhe kërkojnë anulimin e votave nga ky komunitet Egjiptian, për arsye se nuk ka egjiptian në ato komuna dhe ka argumente për keqpërdorim të votave dhe është hera e dytë që ky subjekt e dëmton komunitetin e ashkalinjëve. Më tutje kanë pretenduar se tek anulimi i votave të komunitetit rom në vendbanime ku nuk jeton ky komunitet, subjekti politik IRDK ka manipuluar votat. Parashtruesi i apelit kërkon nga PZAP që gjatë procedurës së shqyrtimit dhe vendosjes së çështjes në fjalë të kërkojë të dhëna nga institucionet shtetërore si AKI, Prokuroria, Policia e Kosovës dhe Agjensioni i Statistikave të Kosovës që sipas tyre këto institucione posedojnë dëshmi të mjaftueshme për këto subjekte që kanë marrë vota. Parashtruesi i apelit ka bashkangjitur një video si dëshmi.

Paneli, pas shqyrtimit të afatshmëris së apelit, gjeti se:

Apeli është i pasafatshëm,

Paneli, vlerëson së në këtë fazë të procesit zgjedhor kur është dorëzuar apeli në PZAP, me pretendime nga ankuesi, që të urdhërohet KQZ-ja, që të bëjë verifikimin e votave, nuk mund të procedohet si apel i afatshëm, sepse në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, i LZP-së, i ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256, përcaktohet se: *“Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”*, nga kjo rezulton se në këtë fazë të procesit zgjedhor që ndodhemi, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, me datë 04.03.2021, mund të parashtrohen apele në PZAP, vetëm për rezultatet e shpallura nga KQZ-ja.

Paneli, vlerëson po ashtu që edhe nëse i referohemi nenit 106 paragrafi 1, të LZP-së, i ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256, në të cilin përcaktohet se: *“KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha ankesat që u përkasin votimit dhe numërimit të vendosura nga PZAP-i dhe çdo apel ndaj vendimeve të PZAP-it lidhur me to të jetë vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës”*, nga kjo del se mund të paraqitet apeli në PZAP vetëm ndaj vendimit të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve që i publikon KQZ-ja, pas përfundimit të gjitha procedurave, në afat prej 24 orëve nga momenti kur KQZ, e shpallë rezultatin përfundimtar siç edhe e ka shpallur me datë 04.03.2021, rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të mbajtura me datë 14.02.2021. Në këtë rast apeli është paraqitur në PZAP me datë 10.03.2021, ndërsa afati për ta apeluar shpalljen e rezultatit përfundimtar të këtyre zgjedhjeve ishte deri me datë 05.03.2021 në ora 11:25.

Nga arsyet e theksuar me lart, e në kuptim të nenit 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.774/2021 më datë 10.03.2021

Kryesuesi i Panelit
Adnan Konushevi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi, në Gjykatën Supreme të Kosovës.